



Nr. 842 - Regj.

Tiranë më 24 .10. 2017

Lënda : Kërkohe të kryet shënimi i bllokimit të aksioneve që ka pala debitore

**QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

**TIRANË**

Për dijeni : Sh "ACI MOBILE" sh.p.k, Adm. Dritan Aga  
: Sh "Plus Comunication" sh.a  
: "Raiffeisen Bank" sh.a

Pranë shërbimit përbarimor "Power & Justice" (P&J) sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është paraqitur për ekzekutim titulli ekzekutiv me pale :

**Kreditor : Raiffeisen Bank sh.a**

**Debitor : Sh "ACI MOBILE" sh.p.k**

**Me objekt : Kthim Shume ( Kredie Bankare)**

Unë përbaruesi gjyqësor Ilir Dervishaj pasi shqyrtova praktikën përbarimore :

**KONSTATOVA**

Në titullin ekzekutiv Kontratë Kredie Nr. 2693 rep, Nr. 1097 kol, datë 28.10.2015 është përcaktuar detyrimi palës debitore të paguaj në favor të Raiffeisen Bank shumat e marra si kredi së bashku me interesat në masën totale prej **2.900.939.96 Euro** .

Për këtë titull ekzekutiv nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është leshuar urdhëri i ekzekutimit me **Nr.3736 Akti date 16.05.2017** . Në urdhër gjykata ka përcaktuar "...që urdhëri i ekzekutimit lëshohet për detyrimin e pashlyer nga shoqëria "Aci Mobile" sh.p.k. në shumën prej 2.900.939.96 Euro që përbëhet nga principlali interesat dhe penalitetet, si dhe kamatat ligjore pas datës 16.05.2017 duke u llogaritur sipas ligjit nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore"....." Pala kreditore ka kërkuar vënien në ekzekutim të këtij urdhëri. Në këto kushte bazuar ne nenin 517 e vijues te K.Pr.Civile sherbimi perbarimor ka derguar ne drejtim te pales debitore njoftimin e ekzekutimin te titullit në mënyrë vullnetare.Ky njoftim eshte nisur ne selin e shoqerise si dhe ne drejtim te administratorit te shoqerise Dritan Aga. Per ekzekutimin e ketij urdheri eshte derguar njoftim dhe ortakut te vetem Sh " Albania Allinvest Capital " sh.p.k si dhe pales hipotekuese Petraq Shomo Lindita Shomo e cila eshte vene ne dijeni nepermjet hipotekuesit Petraq Shomo. **Mbas këtyre komunikimeve pranë shërbimit tonë përbarimor nuk është paraqitur asnjë person si dhe nuk është paraqitur asnjë mandat pagesë për shlyerjen e detyrimit. Gjithashtu pranë shërbimit tonë përbarimor nga palët në proces ekzekutimi debitori, kreditori, hipotekuesit nuk është paraqitur asnjë vendim, kërkesë për pezullim e cila të kufizojë veprimtarinë përbarimore.** Në këto kushte kur afati për ekzekutim vullnetar ka kaluar ne në perputhje me

dispozitat e Kodit të Proçedurës Civile kemi marrë vendimin e kalimit të ekzekutimit në mënyrë të detyrueshme dhe për këtë kemi urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros mbi pasurinë e luajtëshme dhe të paluajtëshme të palës debitore si dhe **vendosjen e shënimit të bllokimit të aktiveve të shoqërisë debitore të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit me qëllim mostjetërsimin e tyre.**

Me pas perfaqesuesit e pales kreditore kane deklaruar prane sherbimit tone perbarimore se pala debitore ka aksione ne masen **4.18 perqind** ne shoqerin "Plus Communication" sh.a . Ne keto kushte bazuar ne nenin 527 e vijues te K.Pr.Civile duhet qe nga ana e jone te urdherohet vendosja e mases se sekuestros dhe mbi aksionet qe ka pala debitore ne shoqerin e mesiperme.

**Për këto arsye :**

Në bazë të Nenit 527 e vijues të K.Pr.Civile si dhe nenit 46 të ligjit nr.10031 date 11.12.2008 "Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat".

**URDHËROJMË**

Vendosjen e shënimit në regjistrat tuaj, për bllokimin e aksioneve prej **4.18** ( kater pike tetëmbdhjet perqind) qe zoteron palë debitore Sh " **ACI MOBILE** " **sh.p.k me Nuis K 12120003**, ne shoqerinë "**Plus Communication**" sh.a me nipt **K 91811014 B** me qëllim mostjetërsimin e tyre.

Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.

Për personat që bëhen pengesë në zbatimin të këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 606 e vijues të K.Pr.Civile.

Ky urdhër u njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor Tirane brënda 5 ditëve, duke filluar afati nga dita e marjes dijeni.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin mbetem ne pritje te veprimit tuaj

*Shenim : Bashkelidhur fotokopjet e Urdherit te Ekzekutimit*

**PËRMBARUESI GJYQËSOR**

*Ilir S. Dervishaj*  
**Ilir S. DERVISHAJ**



5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

ES GJYQËSOR PRIVAT  
S GJYQËSOR PRIVAT

Nr.Regj.Them. 3736

Data e regjistrimit 04.05.2017

Data e vendimit 16.05.2017



«Për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit në dhomë këshillimi»

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga trupi gjykues:

**ANILA KARANXHA - GJYQTARE**

Me cilesinë e gjyqtarit të vetëm në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, sot në datë 16.05.2017, mori në shqyrtim kërkesën civile me Nr. 3736 Akti që i përket:

**Kërkues:** Shoqëria RAIFFEISEN BANK Sh.A., me seli Rruga e Kavajës, pallati 71, shk.1, ap.4, Nr. Nipti J61911005B, përfaqësuar nga Christian CANACARIS.

**Objekti:** Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për kontratën e kredisë Nr.2693 Rep., Nr.1097 Kol., datë 28.10.2015.

**Baza ligjore:** Nenet 510/d dhe 511/ç të Kodit të Procedurës Civile

Gjykata si shqyrtoi aktet e çështjes civile Nr. 3736 Regj.Them në dhomë këshillimi.

**VËREN**

Se kërkuesi, shoqëria RAIFFEISEN BANK Sh.A, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për kontratën e kredisë Nr.2693 Rep., Nr.1097 Kol., datë 28.10.2015.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, gjykata analizoi fillimisht juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 36/1, 41 dhe 511/ç të Kodit të Procedurës Civile, gjykata konstatoi kryesisht se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se: Kërkuesi, shoqëria aksionere "RAIFFEISEN BANK"

ShA, me cilësinë e kredidhënësit ka lidhur një kontratë Kredie bankare Nr. 2693 Rep., Nr. 1097 Kol., datë 28.10.2015, me kredimarrësin Shoqëria "Aci Mobile" ShPK. Sipas kësaj kontrate Banka RAIFFEISEN BANK ShA, i ka dhënë një kredi bankare në shumën 2, 934 533 ( dy milion e nëtëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) Euro, debitorit Shoqëria "Aci Mobile" ShPK, me një afat shlyerje deri më datë 30.09.2022.

Në nenin 11 gërma "a" të Kontratës është përcaktuar se, Bankës i lind e drejta të zgjidhë kontratën dhe kredimarrësi detyrohet të kthejë të gjithë detyrimin ndaj bankës në rastin kur gjatë tre viteve të para kredimarrësi nuk paguan brenda 90 ditëve nga skadenca e afateve të parashikuara në kontratë.

Nga shkresa Nr. 6370 Prot., datë 15.02.2017 e Bankës RAIFFEISEN BANK ShA, drejtuar kredimarrësit Shoqëria "Aci Mobile" ShPK, vërtetohet se kredimarrësi nuk ka paguar për 90 ditë këstet e kredisë dhe i ka kërkuar marrjen e masave urgjente për detyrimet e pashlyera në të kundërt do të vijonte procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të këtij titulli ekzekutiv, duke kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

Sipas shkresës konfirmim mbi detyrimin e kredisë bankare datë 14.04.2017, rezulton se detyrimi i pashlyer që ka debitori Shoqëria "Aci Mobile" ShPK është në shumën 2,900 939.96 ( dy milion e nëtëqind mijë e nëtëqind e tridhjetë e nëntë pikë nëtëdhjetë e gjashtë) Euro .

Në kushtet kur kredimarrësi nuk ka respektuar kushtet e përcaktuara në kontratë për kthimin e shumës së marrë në kredi sipas afatit në kontratë, pala kërkuese i është drejtuar gjykatës për realizimin e përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga kontrata Kredie bankare Nr. 2693 Rep., Nr. 1097 Kol., datë 28.10.2015, duke kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit në mbështetje të nenit 510/d të K.Pr.Civile.

Në nenin 510/d të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: *"Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.....Janë tituj ekzekutiv: .....d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare."* Lidhur me sa më sipër, ndodhur para faktit nëse kjo kontratë për të cilën kërkohet lëshimi i urdhërit ekzekutiv përbën apo jo titull ekzekutiv gjykata konkludon se:

**Së pari:** Kërkuesi, shoqëria aksionere "RAIFFEISEN BANK" Sh.A gëzon personalitet juridik, pasi është rregjistruar si person juridik në QKB. Gjithashtu sikundër rezulton nga ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëria anonime" Sh.A, ekstrakt i nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit, RAIFFEISEN BANK, është regjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si shoqëri anonime që ushtron **"veprimtari në fushën bankare"** dhe ka Nr. J61911005B Nipti.

**Së dyti:** Në nenin 4/1/2 te ligjit nr. 9662 dt 18.12.2006 *"Për Bankat në Republikën e Shqipërisë"* parashikohet se: .....b) **"Veprimtari bankare"** është pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për **dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, si dhe emetimi i mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike**". Ndërsa në nenin 4/1/6 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: **"Kredi"** është marrëdhënia juridike e detyrimit për të lëvruar një shumë monetare në këmbim të së drejtës së ripagimit të shumës së lëvruar dhe të interesit ose

komisioneve të tjera bankare mbi këto shuma, si dhe çdo shtyrje e datës së maturimit të këtyre letre me vlerë të borxhit apo të ndonjë të drejte tjetër për të paguar një shumë monetare”.

**Së treti:** Kontrata e Kredisë Bankare Nr. 2693 Rep., Nr. 1097 Kol., datë 28.10.2015 objekt gjykimi, lidhur midis kredithënësit RAIFFEISEN BANK Sh.A dhe kredimarrësit Shoqëria “Aci Mobile” ShPK siç e parashtruam edhe më sipër, ka për objekt dhënien e një shume monetare, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në kontratën e sipërcituar. Pra është krijuar një marrëdhënie juridike e dyanshme ku palët kontraktuese paraqiten si mbajtës të drejtash dhe detyrimesh. Konkretisht ashtu sikundër rezulton nga kontrata, RAIFFEISEN BANK Sh.A, meqë përsipër detyrimin të lëvrojë një shumë monetare në shumën 2,934,533 Euro në favor të palës tjetër kontraktuese, duke pasur të drejtën të përfitojë nga ripagimi i shumës së lëvruar si dhe të interesit dhe komisioneve të tjera. Nga ana tjetër, kredimarrësi ka detyrimin e ripagimit të kësaj shume së bashku me interesat dhe komisionet e tjera sipas kësteve dhe kushteve të parashikuara në kontratë.

Nisur nga sa më sipër, gjykata çmon se në rastin konkret, kontrata objekt gjykimi Nr. 2693 Rep., Nr. 1097 Kol., datë 28.10.2015, lidhur midis kredithënësit RAIFFEISEN BANK Sh.A dhe kredimarrësit Shoqëria “Aci Mobile” ShPK është në thelb një kontratë kredie bankare siç përcakton neni 4/1/6 në ligjin Nr.9662 dt 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe si rrjedhojë në përputhje edhe me nenin 510/d të K.Pr.Civile ajo përbën titull ekzekutiv.

Detyrimi në këtë kontratë është bërë i kërkueshëm sipas kushteve të kontratës, pasi rezulton se debitori ka dijeni që ka lidhur një kontratë dhe është debitor pranë kësaj Banke, duke mos paguar 3 këste rradhazi të kredisë dhe si rrjedhojë kontrata konsiderohet e zgjidhur, duke i lindur e drejta kreditorit që të kërkojë kthimin e të gjithë kredisë së bashku me interes e penalitetet.

Përfundimisht në analizë të dispozitave të sipërcituara dhe të fakteve të parashtruara rreth rastit konkret, gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit RAIFFEISEN BANK Sh.A, për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit me qëllim shlyerjen e shumës së marrë kredi me kontratën e kredisë bankare është e bazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile

### VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit, Shoqëria RAIFFEISEN BANK Sh.A.
2. Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, për titullin ekzekutiv, që është kontrata e Kredisë Bankare Nr. 2693 Rep., Nr. 1097 Kol., datë 28.10.2015, lidhur midis kredithënësit RAIFFEISEN BANK Sh.A dhe kredimarrësit shoqëria “Aci

Mobile” ShPK, me adresë Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, rruga Nikolla Tupe, pallati 15/3, kati i pestë, përfaqësues ligjor Dritan AGA, Nr. NIPTI K12120003E.

3. Urdhëri i ekzekutimit lëshohet për detyrimin e pashlyer nga debitori Shoqëria “Aci Mobile” ShPK në shumën 2,900,939.96 Euro që përbëhet nga principli interesat dhe penalitetet, si dhe kamatat ligjore pas datës 16.05.2017, duke u llogaritur sipas ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar .
4. Ngarkohen shërbimet përbarimore gjyqësore, shtetërore ose private për zbatimin e këtij urdhri ekzekutimi.
5. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
6. Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje dhe si i tillë ka vlerë.
7. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.
8. U shpall sot në Tiranë, më 16.05.2017.



GJYQTARE  
ANILA KARANXHA



22.06.2017